Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 19
Datë: 05.02.2014

Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve bazuar në nenin 4 me pikat 1,3,6,9 dhe nenit 5 të pikave 1,2,3 të Rregullores së punës për Këshillin Drejtues të AKK-së, si dhe në mbështetje të nenit 14, 15, 16, 17 të kësaj rregullore, si dhe duke u mbështetur në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (nr. 03- L 0600), neni 10, neni 21.3 neni 22, si dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2011, miratuar nga MASHT mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritet Kombëtar i Kualifikimeve nxjerr:

VENDIM

1. Standardet e profesionit të cilat dorëzohen në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve për verifikim duhet që në formatin e AKK-së t'i kenë të plotësuar këto të dhëna:

   1.1 emrat dhe mbiemrat e anëtarëve të ekipit zhvillues (duke përfshirë edhe kualifikimin e tyre);

   1.2 kodin e klasifikimit;

   1.3 vlefshmërinë kohore; dhe

   1.4 datën e zhvillimit.

2. Zhvilluesit e standardeve të profesioneve (institucionet, partnerët social, shoqatat, etj.) duhet të kenë parasysh që përzgjedhja e ekspertëve të cilët angazhohen për zhvillimin e standardeve të profesionit për profilet e caktuara të bëhet sipas kualifikimeve përkatëse.

3. Zhvilluesit e standardeve të profesioneve (institucionet, partnerët social, shoqatat etj) nuk duhet të përfundojnë procesin e zhvillimit të standardeve të profesionit pa përfunduar procesi i verifikimit nga AKK, për shkak të mundësisë për plotësime ose ndryshime të mundshme që kërkohen nga AKK.

4. Ftohen që zhvilluesit e standardeve të profesioneve (institucionet, partnerët social, shoqatat etj) pasi ti kenë zhvilluar standardet e profesionit t'i dorëzojnë në KAAP.
5. KAAP duhet t'i përcjellë standardet e profesionit për procesin e verifikimit në AKK.
6. AKK nuk do t'i pranoj standardet e profesionit në procesin e verifikimit pa u plotësuar kriteret të dala nga pikat e mësipërme.
7. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.
8. Vendimi të gjitha palëve të interesit

Kryetari i KD së
AKK-së
Ragip Gjoshi